

“SIMAK SHOES” sh.p.k.
LAGJJA “BASHKIMI”
RRUGA “SADO KOSHENA”, NR. 10
ZONA INDUSTRIALE, NIPT. L56517201K
VLORE - ALBANIA

Vlorë, më 21.07.2023

LËNDA: Kërkesë per protestë në ambientet e Doganës Vlorë

DREJTUAR: Drejtori i Drejtorise Vendore Vlorë z. **Ermal Muçaj**
Prefekti Qarkut Vlorë, z. **Flamur Mamaj**
Kryetari i Bashkise Vlorë z. **Ermal Dredha**
Deputeti qarkut Vlorë znj. **Pranvera Resulaj**

Te nderuar !

Unë që po ju shkruaj jam Antonio Parente, administator i kompanisë “Simak Shoes” sh.p.k. Operoj në tregun Shqiptar me këtë kompani qysh prej vitit 2015, dhe në projekte të tjera në fushën e fasonerisë nga viti i largët 1993.

Momentalisht tregu i këpucëve të punës është në krizë të thellë e cila shpresojmë të përmirësohet nga vjeshta e vitit 2023.

Kursi i këmbimit të Euros na ka goditur rëndë, gjithë të ardhurat tona në Euro do të këmbehen dhe shkojnë për pagesën e pagave të punonjëjsve, kontributet e Sigurimeve Shoqerore dhe Shëndetësore në lekë. (rreth 80-90 % e të ardhurave shkojnë për këto). Jemi përpjekur të bëjmë më të mirën për përmirësimin e pagave të punonjësve, ku ekzekutimi i tyre ne sistemin bankar kryhet 100 %. (statistikat e tatimeve e konfirmojnë këtë).

Për gati dy javë janë bllokuar në menyre të padrejtë nga Organet Tatimore veprimet në doganë. Konkretisht nga Drejtoresha Rajonale e Tatimeve (sektori borxhit) znj. **Anilda Aliaj**.

Blokim është kryer pa njoftim paraprak të specifikuar "Blokim për veprimet doganore". Kemi pasur vetem njoftim për fillimin e masave shtrenguese. Jemi në kushtet kur nga reth 10.6 Mil lekë që ishte njoftimi për bllokim, deri më datën 20.07.2023 detyrimi për pagesë është rreth 3.3 Mil lekë (shuma e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore të një muaji pune). Me gjithë perpjekjet e punonjësve të Ministrisë së Financave, Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve z.Ceno Klosi, Drejtoresha në fjalë nuk jep asnjë hapësirë për të liruar doganën, qoftë dhe për disa ditë, mjafton që kamioni me lëndë të parë të shakrkohe, punonjësit të rifillojnë punën dhe në të kryejmë eksportin nga i cili fondet që do të vijnë në llogari të shlyejnë dhe ato pak detyrime të mbetura.

Drejtoresha në fjalë nuk zbaton as klauzolat e Ligjit 9920, neni 77 pika 7, ku pavarësisht parashikimeve ligjore, lejon klauzolën e kryerjes së një marrëveshje për pagesën me keste të detyrimeve të cilën ja kemi kërkuar disa herë. (thjesht marrëveshje për zhblokim dogane)

Dëmet e shkaktuara ndaj kompanisë për vonesa në dorrëzimin e produktit janë shumë të larta dhe ne do t'i pretendojmë në rast të përshkallëzimit të situatës, kjo është një përgjegjësi administrative dhe ndaj aksionerëve tanë.

Nisur nga më sipër, duke qënë se dhe rreth 200 punonjës janë pa punë kërkojmë nga JU:

- **Leje për zhvillimin e një proteste në ambientet e Doganës Vlorë ditën e shtunë datë 22.07.2023 në orën 11.00.**

Duke ju Falenderuar !

ADMINISTRATOR

ANTONIO PARENTE

0692060740

